

**Republika e Kosovës**


**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **26 mars 2015**, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblime për nxënës, duke u bazuar në Nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, Nenin 12 të Statutit të Komunës, Nenin 7 të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2013 për transparencë nëpër komuna, si dhe Nenin 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

**V E N D I M**  
**për dhënie në diskutim publik**

1. Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblime për nxënës.
2. Diskutimi publik fillon nga data 27 mars 2015 dhe zgjatë deri më 17 prill 2015.
3. Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
4. Obligohet Drejtoria për Arsim që si hartues dhe propozues i Draft-Rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013. Gjithashtu DA-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Prill 2015.
5. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

**Shpëtim Zhegrova**  
  
**Kryesues i Kuvendit**



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në Nenin 12 paragrafi 2 pika "d" lidhur me Nenin 17 pika (f) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Nenin 79 pika (t) të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **26 mars 2015**, mori këtë:

### V E N D I M për hapjen e trasesë së rrugëve për vitin 2015

1. Me këtë Vendim caktohen rrugët lokale të cilat do të hapen dhe do të trajtohen me zhavorr në Komunën e Vushtrrisë;


- 1.1 Rruga në fshatin Skoçne,
- 1.2 Rruga në fshatin Kunovik,
- 1.3 Rruga në fshatin Kurillovë,
- 1.4 Rruga në fshatin Beçuk dhe
- 1.5 Rruga në fshatin Stanoc i Poshtëm.

2. Hapja e trasesë së këtyre rrugëve publike dhe trajtimi i tyre me zhavorr do të bëhet me mjetet e planifikuara për vitin 2015.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

4. Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Shpëtim Zhegrova**  
  
**Kryesues i Kuvendit**



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në Nenin 12 paragrafi 2 pika (d) lidhur me Nenin 17 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 79 pika (h) të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **26 mars 2015**, mori këtë:

### V E N D I M për caktimin e lokacioneve për parkingje publike

1. Me këtë Vendim caktohen lokacionet për rregullimin e parkingjeve publike në Komunën e Vushtrrisë:

- 1.1. Sipërfaqja prej 1,225 m<sup>2</sup> në ngastrat kadastrale 504 dhe 505 te ish-stadiumi i hendbollit,
- 1.2. Sipërfaqja prej 630 m<sup>2</sup> në ngastrën kadastrale 598/2 prapa banesave që gjenden përballë Kalasë së Qytetit,
- 1.3. Sipërfaqja prej 273 m<sup>2</sup> në pjesën e rrugës publike përballë palestrës së sporteve "Jeton Tërstena".

2. Rregullimi i këtyre hapësirave për parkingje publike do të bëhet me mjetet e planifikuara për vitin 2015, ndërsa menaxhimi i tyre do të bëhet në bazë të Rregullores për parkingje publike që do të hartohet nga Drejtoria për Shërbime Publike.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

4. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi: Certifikatat pronësore dhe kopjet e planit.

5. Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova  
Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MËDITIT DHE PLANIFIKIMIT HARËSHINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGJENCIA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202016-00504-0

Numri i lëndës / Broj Predmet/Case Reference Number:

Certificate-2-5670

Data dhe koha e tëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

24.02.2015 - 9:59

Komuna / Opština / Municipality:

Vushtri/Vučitë/Vushtri

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

VUSHTRRI/VUSHTRRI/VUSHTRRI

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

Vushtri/Vučitë/Vushtri

Drejtori/Direktor/Director

Referenti/Referent/Referent

A. TE DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. unit No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronësisë Vrsta inovine Property Type	Zona U/R U/R U/R	Sipërfaqja Površina Area m <sup>2</sup>	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradeno na dan Created on	Azhurnuar Ažurirano Updated
P-70202016-00504-0	PARCELË/PARCELA/ PARCEL	Pronë shoqërore/Drushivena Inovina/Socially owned Land		6465		09.07.2013	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Zvano mesto Place name	Kodi postar Poštanski fah Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Krijuar më datën Uradeno na dan Created on	Azhurnuar Ažurirano Updated
VAROSH/MARSHALA TTTA/VAROSH/MARSHALA TTTA/VAROSH/MARSHALA TTTA/VAROSH/MARSHALA TTTA	-		09.07.2013	

A.2 LLOJJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORIËÇENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriëçenja parcelle Parcel type of use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriëçenje parcelle Parcel current use	Klasa e kualitetit Klasa kualiteta Quality/Class	Sipërfaqja Poverëshna Area (m2)
1	Toke Tjeter/Ostalo Zemljište/Other Land	Jo Pjellorë/Neplodno/Unproductive		6465

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licensi broj ID. no.	Vendbanimi Prehvatishite Residence	Kodi postaral Poštanski fah Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Pjesa e pronës Deo inovine Share quota	Përshkrimi Opis Description	Azhurnuar Azurirano Updated
Pronësi individuale (Një Pronarë)/Individualno Vlasništvo (1 V.)/single owner	P SH, KOMUNA E VUSHTRRIË	KCID0201037	VUSHTRRI/VUSHTRRI/VUSHTRRI	-	2 /	1/1		





Republika e Kosovës  
Republica Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MUEJESIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA /CADASTRAL UNIT : P-70202016-00505-0

Numri i lëndës / Broj Predmet/Case Reference Number:

Certificate-2-5671

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

24.02.2015- 9:59

Komuna / Opština / Municipality:

Vushtri/Vučitrn/Vushtri

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

VUSHTRRI/VUSHTRRI/VUSHTRRI

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

Vushtri/Vučitrn/Vushtri

Drejtori/Direktor/Director

Referenti/Referent/Referent

A. TE DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI /CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. unit No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronësisë Vrsta imovine Property Type	Zona U/R U/R	Sipërfaqja Površina Area m <sup>2</sup>	Peshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradeno na dan Created on	Azhurnuar Ažurirano Updated
P-70202016-00505-0	PARCELË/PARCELA/ PARCEL	Pronë shoqërore/Društvena Imovina/Socially owned Land		2794		09.07.2013	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i qajtur Zvano mesto Place name	Kodi posttal Poštanski fah Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address Details	Krijuar më datën Uradeno na dan Created on	Azhurnuar Ažurirano Updated
VAROSH/MARSHALA TITA/VAROSH/MARSHALA TITA/VAROSH/MARSHALA TITA	-		09.07.2013	

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORIÇËNJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriçënjia parcelle Parcel type of use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutro koriçënjie parcelle Parcel current use	Klasa e kualitetit Klasa kualiteta Quality/Class	Sipërfaqja Površina Area (m2)
1	Tokë Nderimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land	Oborr/Dvorëste/Back Yard		2306
2	Tokë Nderimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land	Shtëpi-Ndertese/Kuca-Zgrada/House-Building		488

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. no.	Vendbanimi Prebivalište Residence	Kodi postar Poštanski fah PostalCode	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Pjesa e pronës Deo inovine Share quota	Përshkrimi Opis Description	Azhurnuar Ažurirano Updated
Pronësi individuale (Një Pronare)/Individualno Vlasništvo (1 VI.)/single owner	P SH. KOMUNA E VUSHTRRISE	KCID0201037	VUSHTRRI/VUSHTRRI/ VUSHTRRI	-	2 /	1/1		



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDIST DHE PLANIFIKIMIT HAPËSHINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFICAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA /CADASTRAL UNIT : P-70202016-00598-2

Numri i lëndës / Broj Predmet/Case Reference Number:	Certificate-2-5672
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	24.02.2015-10:01
Komuna / Opština / Municipality:	Vushtri/Vučitrn/Vushtri
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	VUSHTRRI/VUSHTRRI/VUSHTRRI
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	Vushtri/Vučitrn/Vushtri

Drejtori/Direktor/Director

A. TE DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI /CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. unit No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronësisë Vrsta imovine Property Type	Zona U/R U/R	Sipërfaqja Površina Area m2	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradeno na dan Created on	Azhurnuar Ažurirano Updated
P-70202016-00598-2	PARCELE/PARCELA/ PARCEL	Pronë private/Privatna Imovina/Privately owned Land		634		00-2004	09.07.2013

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Zvano mesto Place name	Kodi postar Poštanski fah Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Krijuar më datën Uradeno na dan Created on	Azhurnuar Ažurirano Updated
VAROSH/BORISA KIDRIÇA/VAROSH/BORISA KIDRIÇA/VAROSH/BORISA KIDRIÇA	-		09.07.2013	




A.2 LLOJTI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORIÇËNËJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriçënjia parcelle Parcel type of use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriçënjie parcelle Parcel current use	Klasa e kualitetit Klasa kualiteta Quality/Class	Sipërfaqja Površina Area (m2)
1	Tokë Nderimnore/Gradëvinsko zemljište/Construction land	Oborr/Dvoritë/Back Yard		500
2	Tokë Nderimnore/Gradëvinsko zemljište/Construction land	Shtëpi-Ndërtesë/Kuçe-Zgrada/House-Building		134

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. no.	Vendbanimi Prebvalište Residence	Kodi postar Poštanski fah PostalCode	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pëshkrimi Opis Description	Azhurnuar Azurirano Updated
Pronësi individuale (Një Pronare)/Individualno Vlasništvo (1 VI.)/single owner	P SH. KOMUNA E VUSHTRRIË	KCID0201037	VUSHTRRI/VUSHTRRI/ VUSHTRRI	-	2 /	1/1	00-2004	





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në Nenin 12 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Nenin 7 të Ligjit Nr.04/L-44 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Nenit 4 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për Caktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Nenin 41 paragrafi 2 pika (ç) të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **26 mars 2015**, mori këtë:

### V E N D I M

#### për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të objektit pronë e paluajtshme komunale

1. Me këtë Vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e objektit pronë e paluajtshme e Komunës së Vushtrrisë, e cila gjendet në rrugën "Ismail Qemajli" në Vushtrri, ngastra kadastrale Nr. P-70202016-00086-0, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e komunës, e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 39 m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 125 m<sup>2</sup>.

2.1. Objekti i cekur në pikën 1 të këtij Vendimi jepet në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandit për personat fizikë dhe juridikë, si objekt i karakterit të përkohshëm (montazh) në kohëzgjatje prej pesë (5) viteve me mundësi vazhdimi edhe për pesë (5) vite tjera;

2.2. Çmimi fillestar për m<sup>2</sup> është dy (2) € në muaj;

2.3. Të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me lokalin në fjalë i bartë përfituesi i ankandit;

2.4. Komuna rezervon të drejtën e shkëputjes së njëanshme të kontratës, nëse një gjë të tillë e parasheh interesi i përgjithshëm, dhe në këtë rast komuna duhet ta njoftojë shfrytëzuesin e objektit së paku tridhjetë (30) ditë para ndërprerjes së kontratës.

3. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale që të zhvillojë procedurat për shpalljen e ankandit, si dhe obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e të gjitha shpenzimeve pas lidhjes së tyre.


4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

5. Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova

Kryesues i Kuvendit





**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në Nenin 12 paragrafi 2 pika (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Nenin 41 paragrafi 2 pika (ç) të Statutit të Komunës, si dhe në Kërkesën nr.02-007-22903 dt. 10.03.2015, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **26 mars 2015**, mori këtë:

### **V E N D I M**

**për lejimin e mjeteve financiare për renovimin e zyrave të Shoqatës për persona të verbër dhe shikim të dobësuar “Drita Jonë”**

1. Me këtë Vendim lejohen mjete financiare në vlerë prej dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë e nëntëdhjetë e pesë (2,458.95) € për renovimin e zyrave të Shoqatës për persona të verbër dhe shikim të dobësuar “Drita Jonë”, të cilat gjenden në objektin e ish-TMK-së.
2. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij Vendimi lejohen konform Rregullores 01.Nr37-2/11 dt.24.02.2011 për caktimin e kriteve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jopublike.
3. Për shfrytëzimin e mjeteve financiare të cekura në pikën 1 të këtij Vendimi obligohet përfaqësuesi i OJQ-së që të lidhë marrëveshje me Komunën e Vushtrrisë.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Administratë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe Drejtoria për Prokurim Publik.
5. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është tabela me emërtimin “paramasa dhe paralogaria për renovimin e zyrave të qendrës për të verbërit”.
6. Ky Vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Shpëtim Zhegrova**  
  
**Kryesues i Kuvendit**  


Republika e Kosovës  
Kuvendi Komunal -Vushtrri  
dhe Drejtoria per Urbanizem  
, mbrojteje te mjedisit



PARAMASA DHE PARALLOGARIA PER RENOVIMI ZYREVE TE  
QENDRES PER TE VERBET

A	PERSHKRIMI I PUNEVE	NIESIA	SASIA	QMIMI	TOTALI €
1	Përgaditja e hapsirave, konsulta me personelin për organizimin e punimeve, përgaditja e mekanizmave të nevojshëm	paushall	1	20,00	20
2	Furnizimi me material dhe rishiki l rjetit elektrik perfeshire edhe furnizimi dh evendojen e 7 shtekave , dhe 4 nderpresa poqa elektrik 6cope,	paushall	1	180,00	180
3	Furnizimi me material dhe ndrrimi l brave te dyerve dhe dritareve ,përfeshirë edhe të gjitha materialet e nevojshëme	cope	12,00	9	108,00
4	Furnizimi me material për lryjen e mureve dhe pllafonëve te hapsirave të brendshme me polkoloze në dy shtresa nianaca e caktuare nga org. mbikqyrës	m <sup>2</sup>	237,50	1,1	261,25
5	Furnizimi me materil dhe instalimi l rjeteit të kanalizimit gypti shkarakues me gjatesi mesatre L=25m'Ø100mm;l=15m'Ø75mm;l=15m'Ø50mm perfeshire edhe te gjitha elemetet percjellëse për funksionalizimin e rjeteit , nëkete pozcione eshte perfeshire edhe thyjet e betonit ,dhe lidhjet me gypin kryesore	paushall	1,00	250	250,00

6	Furnizimi me materijl dhe instalimi i rrieteit të ujisellesit me gjatesi mesatre L=25m' 3/4;L=45m'1/2mm;L=15m'5/4mm perfeshire edhe te gjitha elementet percjellese për funksionalizimin e rrieteit , sistemi gjakomin , me kolektore dhe ormani shperndares ,nëkete pozcione eshte perfeshire edhe thyret e betonit ,dhe lidhjet me gypin kryesore	paushall	1,00	350	350,00
7	Furnizimi me material të nevojshem për lidhjen në gypin kryesore perfeshire edhe të gjitha punet percjellese për thyrje te betonit dhe materijet shtese per kyqje ne rrijet	m'	16,00	3,5	56,00
8	Furnizimi dhe montimi i wc shole komplet , llavabo komplet perfeshire edhe baterin ,pasqyre me dimensione 65x25cm,	paushall	1,00	350	350,00
9	Furnizimi dhe montimi i dritares 60x80nga PVC me trashesi t=7cm	cope	1,00	50	50,00
10	Furnizimi dhe montimi i deres 100x210nga PVC me trashesi t=7cm	cope	1,00	120	120,00
11	Furnizimi dhe muratimi murt ndares me trashesi t=20cm ne sipërfaqe 3.5x2.20	m <sup>2</sup>	7,70	20	154,00
12	Furnizimi me material dhe suvatimi me llaq gelqero t dhe harrnimi rreth dritares	m <sup>2</sup>	15,40	5,5	84,70
13	Furnizimi me material dhe ngjitja e keramikave per muret dhe dysheme, perfeshire edhe hidroizolimn dhe ngjitesin	m <sup>2</sup>	38,00	12,5	475,00
TOTAL I PUNEVE TE PEREUNDUARA					2.458,95

NEXHAT MEROVCI